



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
KRYETARI KËSHILLIT

Nr. 2234 Prot

Gramsh më 25.06 2021

VENDIM

Nr. 83 dt. 29/06/2021

Për

“ Miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga tërmeti në banesën e z. Nevruz Çela, banor në lagjen Sporti 2, bashkia Gramsh, si dhe dëmshpërblimin financiar”.

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 29.06.2021, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, sektori i Emergjencave Civile dhe “Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga tërmeti në banesën e shtetasit Z. Nevruz Çela, banor në lagjen Sporti 2, bashkia Gramsh si dhe dëmshpërblimin financiar”, bazuar në:

- Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligjin 45/2019 “Për mbrojtjen civile”;
- VKM nr.329 datë 16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”;

VENDOSI:

1. Miratimin e dokumentacionit tekniko-ligjor të hartuar nga specialistët e Bashkisë Gramsh.
2. Të miratojë vlerën e dëmshpërblimit financiar bazuar në V.K.M. Nr. 329 datë 16.5.2012 e cila është **50%** të vlerës së preventivit të përlogaritur bazuar në dëmet e shkaktuara nga tërmeti në banesë, d.m.th. $742\ 231 \times 50\% = 371\ 116$ lekë, pra vlera e dëmshpërblimit për shtetasin Z. Nevruz Çela është në **371 116** (treqind e shtatëdhjetë e një mijë e njëqind e gjashtëmbëdhjetë e gjashtë) lekë.
3. Ti paraqesë dokumentacionin përkatës dhe ti kërkojë mbështetje financiare Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Ministrisë së Mbrojtjes, për akordimin e dëmshpërblimit prej **371 116** (treqind e shtatëdhjetë e një mijë e njëqind e gjashtëmbëdhjetë e gjashtë) lekë Z. Nevruz Çela.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike (Sektori i Emergjencave Civile).

Sekretari i Këshillit të Bashkisë

XHULIA GJINI

Konceptoi: Xh. Gjini
Pranoi: G. Lena
Miratoi: G. Lena

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

GRETA LENA

